

Procesverbal

Konsultim publik : Banorët e *Bashkisë Pogradec*,

Data : 20/02/2024

Ora : 15:00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 19 persona të pranishëm .

Titulli : “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.105,DATË 02.12.2021, PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE” DHE “HARTA QË PËRCAKTON RRUGËT E QYTETIT ,TË CILAT PËRJASHTOHEN NGA KJO RREGULLORE”

Pjesëmarrës :

Manjola Kamolli (Kryetare Këshilli)

Celnik Haxhillari (Këshilltar)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Klea Topa (Këshilltare)

Besnik Xhyra (Këshilltar)

Alketa Beka (Këshilltare)

Marjeta Biba (Këshilltare)

Jona Bojko (Sekretare Këshilli)

Matilda Tollaku (Sekretariati I Këshillit

- Takimi drejtohet nga kryetarje e Këshillit Manjola Kamolli e cila bëri një prezantim të shkurtër për qëllimin e konsultimit dhe I ftoi banorët të shprehnin mendimin e tyre .
- Më pas fjalën e mori Nënkryetari I Bashkisë z.Paskalino Ziko, njëkohësisht drejtor I drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit:

-Paskalino Ziko: Ka qënë një vendim I vitit 2021, të cilin kemi menduar të bëjmë disa ndryshimë në dy rrugët kryesore. Kemi menduar të bëjmë një ndryshim të rruga Fan Noli. Me idenë që cdo biznes të ketë mundësi të shfrytëzojë hapësirën dhe rruga të bëhet si një pedonale dhe të marrë zhvillim. Bizneset kanë mundësi të bëjnë kontrata I vjecare dhe jo vetëm sezonale në mënyrë që qyteti të marrë një zhvillim jo vetëm sezonale. Bashkia ka aplikuar me një projekt të fondi shqiptar I zhvillimit.. Bashkia ka hartuar një projekt për transformimin e shetitores dhe sipas këtij koncepti, sic e shikoni të dyja krahet ndalohej makinat vetëm në dy pjesë të vogla sic është pjesa e materniteti të lejohet për makina. Pjesa tjetër do të jete pedonale për këmbësorët. Projekti përfshin rikonstruksionin e shetitores dhe të fasadave dhe pjesa e mezzit do të ngelet shëtitore për qytetarët jo si sot që zihet nga tavolinat. Pra me një shembull si lokali Hymeti Palce të njëjta kushte do të plotësojnë të gjithë lokalet. Mund të zhvendoset ajo pjesa e veprës së artit që është në fillim. I njëjti koncept do realizohet dhe për të pjesa e shetitores. Kjo është pak a shumë ideja. Cfarë pyetje ka nga qytetarët që ti sqarojme.

-Marjeta Biba: Kjo ka ardhur si rezultat I kërkesave dhe sa biznese janë dakort?

-P.Ziko: Jo nuk ka ardhur si pasojë e kërkesave nga bizneset por të gjitha bizneset janë dakort. Patjetër që do ju imponohet ky projekt.

-M.Biba: Do ju shërbeje bizneseve po jo qytetareve.

-P.Ziko: Patjetër që jo ju shërbeje qytetareve sepse do të jete shetitore , makina nuk do kalojnë, do krijojmë vetëm dy mundësi që të lidhet materniteti nëpërmjet një kalimi emergjence nga pjesa e elektrikut që të lidhet me maternitetin.

-Banori 1: Aksi naga elektrikut do jete e lirë?

-P.Ziko: Po do të jete I lirë.

-Berti Cami (Org e Dëshmorëve) Dy problem kemi në lidhje me hapësirat publike. Te busti I dëshmorit Mirash Gjoka , lulishten e kanë zënë nga një ndërtim dhe nuk duket busti fare. Ai është bërë dhe me vendim të Këshillit Bashkiak.

-P.Ziko: Do të dërgojmë inspektorët e Policisë Bashkiake që ta vërtetojmë .

-Niko: Zutë vetëm pjesën të Enkelana dhe poshtë ndërsa pjesa nga ana tjetër nga turizmi I vjetër ngelet jetim, plus rruga më e vjetër e qytetit “Naim Frashëri ” është bërë për të ardhur keq. Rruga bllokohet keq nga makinat.

-P.Ziko: Është një projekt I cili përfshin të gjithë atë lagjen me rikonstruksionin e banesave. Rruga Naim Frashëri do të fillojë së shpejti.

-Niko: Te rruga Gani Omcani janë disa furgona që parkojnë dhe qarkullojnë atje dhe kemi frikë për fëmijët që luajnë atje.

-z.Hoxhalli: Te lagjia Kala nuk ka kanalizim të ujrave të bardha, përse I përket hapësirave publike është një shesh që ta bëjmë për të moshuarit.

-z.Guri: Unë e pash projektin me fokusin tim si qytetar por nuk mendoj se duhet ti japim prioritet veëm Biznesit.

-A. Beka; Të gjitha këto biseda janë të përgjithshme nuk janë konkretisht për konsultimin të cilin jemi mbledhur.

-P.Ziko: Nqs nuk keni dicka për të shtuar, ju faleminderit!

Mbajtësi i procesverbalit

Jona Bojko

